



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRISHTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 24905/11

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Istref Klinaku nga fsh. Mazgit, për kundërvajtje nga neni 6 par. 1 dhe 2 e sanksionuar sipas neni 16 paragrafi 1.2 i Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Ligji nr. 3/L - 151, e në bazë të nenit 73,74,195, 199, 10 të LMK me dt. 09.12.2011 merr këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI : Istref Zeqit Klinaku, i lindur më 09.12.1958 ne fsh. Bivolak K. Vushtrri, tani më vendbanim në fsh. Mazgit, me profesion drejtor ekzekutiv i KEK-ut, fakultetin të kryer, i gjendjes së mesme ekonomike.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

I pandehuri në cilësinë e drejtorit ekzekutiv Divizionit të Gjenerimit të KEK-ut, ka qen i obliguar me ligj që në afatin ligjor deri me 31.03. 2010, ta deklaroj pasurin e paraparë me ligj, në Agjensionit Kundër Korrupsionit ,ku i njëjta nuk e ka deklaruar pasurin e vetë, të përcaktuar sipas keti ligji.

Me këtë ka kryer vepër kundërvajtëse nga **6 par. 1 dhe 2 e sanksionuar sipas 16 paragrafi 1.2 i Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Ligji nr. 3/L -151**, andaj për këtë:

Q O R T I M

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjensia Kundër Korrupsionit , parashtroi kërkesën nr.01-3198/11 të dt 09.07.2010 për fillimin e procedurës kundërvajtës kundër të pandehurit së përmendur më lartë dhe për kundërvajtjen e lartcekur.

Gjatë procedurës u dëgjua i pandehuri i cili në deklaratën e tij, deklaroi se në cilësinë e drejtorit Ekzekutiv te Gjenerimit te KEK-ut në bazë të pozitës sime, nuk jam i obliguar qe ta paraqes pasurin time në ketë Agjension në bazë të Ligjit, emrin tim në ketë listë është futur nga një person i pa autorizuar, dhe përmes imelave me kanë dërguar se jeni i obliguar qe ta paraqitni pasurin dhe formularët mund ti merrni në Web faqen e agjensionit Ani Korrupsion. Unë ketë e kam kontestuar brenda KEK-ut të dhe nuk kam marrë kurrfar nga personat përgjegjës të KEK-ut, dhe me dt. 19.09.2011 nga zyra Ligjore e KEK – ut e nënshkruar nga Sani Berisha ka sjell sqarim lidhur me pozitën e tij, brenda KEK-ut Konkluzion se Istref Klinakut në pozitën të cilën ushtron nuk radhitet në pozitën e personave zyrtare publik.

Për vërtetimin e gjendjes faktike u dëgjuar parashtruesi i kërkesës Enis Sadiku i cili ne deklaroi se sa i përket kërkesës te cilën e kemi parashtruar për Istraf Klinakun drejtor ekzekutiv i gjenerimit në KEK ku sipas pikë kontaktuese ne mes te KEK dhe agjensionit Kundër Korrupsion është përfshirë edhe emri i tij i cili benë pjesë në kuadër te emërimeve te larta publike për deklarimin e pasurit ku dhe na kemi bërë kërkesën ndaj tij, ku mbështetje ka e neni 3 i përkufizimit te shprehjeve të përdoruar ne piken 1.7 ku është drejtor sipas funksionit dhe konkludoj ne fund se ne bazë të nenit 3 pika 7 nen kupton se është fjala për drejtorët dhe anëtar te bordit te Kompanisë Publike qe më vete përfshin te gjitha postet te drejtorëve brenda një kompanie Agjensioni konsideron se kërkesa është arsyeshme dhe e bazuar.

Andaj gjyqtari pasi administrimit te provave dhe të provuarit te kësaj çeshtje, në mënyrë të drejt dhe te plotë vërtetoi gjendjen faktike ku i shqiptoj Masën Qortim konform nenit 10 të LMK-së, pasi qe u konstatua se i pandehuri ka qenë i vu në lajthim Juridike nga zyra ligjore e KEK-ut, të cilën e kanë konsideruar se është person i cili nuk është i radhitur në pozitën, për ta deklaruar pasurin e tij në Agjension. Ndërsa me te drejt është vërtetuar gjendja faktike se i pandehuri me Ligjin kundër Korrupsion të nenit 3 të përkufizimit i personave te obliguar për paraqitjen e pasurisë shihet se është i obliguar ta paraqes pasurin dhe për shkak te rrethanave me te cilën është gjendur i pandehuri gjyqtari morri si rrethanë lehtësuse, ku shqiptoj **Masën Qortim** andaj mund të pritet qe edhe pa dhënien e dënimit, dhe i njëjti ne të ardhmen do të shmanget nga kryerja e veprave të këtilla dhe të ngjashme, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KESHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala dhe ushtruesi i kërkesës ankesë mund ti ushtrojnë Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë nëpërmes të kësaj Gjykate ne afat prej 8 ditësh prej ditës se pranimit të të njëjtit dhe pa kusht vendosi GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

GJYQTAR PËR KUNDËRVAJTJE
Fatmir Durrani

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. <u>D.P</u> Nr. I faq. Broj, stranica Nr. pages	Nr. Prot Br. Prot Prot No <u>03-5154/11</u> Data Datum <u>30.12.2011</u> Date
PRISHTINE	